

## **GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**

**P. nr. 199/2015**

**14 qershor 2016**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS** me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Franciska FISER, si Kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarët e EULEX-it Vidar STENSLAND dhe Rene Van VEEN si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Këshilltarit Ligjor të EULEX-it, Dukagjin KËRVESHI si procesmbajtës, në lëndën penale kundër:

**S.G., i lindur më ..., në fshatin ... në Skenderaj, me banim në të njëjtën adresë të përhershme, i punësuar në ..., i martuar, baba i tre fëmijëve, me gjendje mesatare ekonomike;**

*i akuzuar me:*

- **Vrasje të rëndë** të I. I. në shkelje të nenit 147, pika 4) të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK); dhe
- **Mbjatje në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi (2) i KPK-së;

*Dhe*

**A.G., emri i babait ..., emri i nënës ..., mbiemri i vajzërisë ..., i lindur më ... në fshatin ... në Skenderaj, shqiptar i Kosovës, me banim në rrugën ..., Mitrovicë, i papunë, i martuar, baba i tre fëmijëve, me gjendje mesatare ekonomike;**

*akuzuar me:*

- **Vrasje e rëndë** e M. I. në shkelje të nenit 147, pika 4) të KPK-së;
- **Tentim vrasje e rëndë** e B. I. në shkelje të nenit 147, pika 4) të KPK-së; dhe
- **Mbjatje në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi (2) i KPK-së;

të dytë të akuzuar me Aktakuzën e Prokurorisë së Republikës së Kosovës, të datës 26 maj 2010, e ndryshuar më 17 mars 2016 dhe 13 qershor 2016;

*pas* mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, të gjitha të hapura për publikun, më 7 mars 2016, 17 mars 2016, 23 mars 2016, 26 prill 2016, 29 prill 2016, 10 maj 2016, 13 qershor 2016 dhe 14 qershor 2016, vizitës në vendin e ngjarjes më 26 prill 2016, të gjitha në prani të Prokurorit të EULEX-it të Republikës së Kosovës, të pandehurit S.G. dhe avokatit të tij mbrojtës H. Zh., të pandehurit A.G. dhe avokatit të tij mbrojtës H. M., më 7 mars 2016, 17 mars 2016, 23 mars 2016, 26 mars 2016 gjithashtu në prani të palës së dëmtuar B. I. dhe më 17 mars 2016 gjithashtu në prani të palës së dëmtuar F. I.;

*pas* këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 14 qershor 2016;

*në pajtim* me nenin 392, paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK) më 30 qershor 2016 në një seancë publike dhe në praninë e të pandehurit S.G., të pandehurit A.G. dhe Prokurorit të EULEX-it;  
nxjerr si më poshtë:

## **AKTGJYKIM**

### **I.**

Nën PIKËN 1, Vrasje e rëndë e M.I. dhe nën PIKËN 2, Tentim vrasje e rëndë e B. I:

i pandehuri **A.G.** shpallet **FAJTOR** për shkak se:

Më 4 dhjetor 2009, pas orës 12.00 pranë kryqëzimit të rrugëve "... dhe ..." në Mitrovicë, më saktësisht jashtë shtëpisë së R. G., në rrugicën e vogël që kalon para shtëpisë së G. dhe që çon në kthesën e majtë të shtëpisë së I., A.G. me S.G., A. G. dhe R. G. u takuan me I. I., B. I. dhe M. I.. Për shkak të një konflikti të vazhdueshëm ndërmjet familjeve të të ndjerit I. I. dhe R. G., anëtarët e të dy familjeve filluar të grinden me fjalë, e cila erdhi deri te një përleshje me grushte në mes S.G. dhe B. I.

Pastaj B. I. hipi me shpejtësi në makinën e tij ... bashkë me gruan e tij M. I. dhe shkuan në drejtim të qendrës së Mitrovicës në mënyrë që të kërkonin ndihmë nga policia, ndërsa anëtarët e tjerë të të dy familjeve qëndruan aty.

Pas një kohë të shkurtër, B. I. dhe M. I. u kthyen me ..... Makina e policisë erdhi menjëherë pas ... dhe u ndal në anën perëndimore të rrugës së "...", ndërsa B. I. u kthye në rrugën "...".

Ndërsa B. I. po e ngiste veturën në rrugën "...", A.G., S.G., A. G., R. G. dhe I. I. po qëndronin në rrugën pranë kthesës së majtë të rrugicës.

A.G. e drejtoi armën e tipit M57-TT me numër serik ... dhe shtiu në makinën ...që po afrohej. B.I. pastaj e ktheu makinën drejt A.G. dhe e goditi A.G. me pjesën e përparme të anës së majtë të automjetit.

B.I. vazhdoi të ngiste veturën pas goditjes dhe kur ai ishte gati për t'u kthyer drejt shtëpisë së I., A.G. shtiu me armën e tij në drejtim të makinës ..., duke e marrë në shenjë B. I. dhe e qëlloi në krahun e tij të majtë. Me këtë A.G. qëllimisht u përpoq për të privuar nga jeta viktimën B. I..

B.I. vazhdoi që ta ngiste veturën ... rreth qoshes, u ndal para portës së I. dhe kërcëu mbi mur në oborrin e I., ndërsa A.G. e ndjeku makinën.

M.I. ishte duke dalë nga automjeti, kur A.G. gjuajti qëllimisht me armën-pistoletën e tipit M57-TT me numër serik ..., në drejtim e saj dhe e goditi M. I. në krahun e djathtë dhe shkaktoi një plagë vdekjeprurëse. Trajektorja e kësaj predhe shkoi nga ana e djathtë në drejtim të anës së majtë, dhe nga lart poshtë, dhe pak prapa; plumbi u gjet në vrimën e majtë të kraharorit. Me këtë, A.G. ka privuar nga jeta viktimën M. I..

Në këtë mënyrë, A.G. ka kryer:

- Veprën penale të Tentim vrasjes të B. I., në kundërshtim me Nenin 146 të KPK-së, në lidhje me nenin 20 të KPK-së; dhe

- Veprën penale të Vrasjes së M. I., në kundërshtim me Nenin 146 të KPK-së, dhe

PRANDAJ **A.G. DËNOHET** për kryerjen e veprës penale të **Tentim vrasjes së rëndë**, në kundërshtim me nenin 147, pika 11) të KPK-së në lidhje me nenin 20 të KPK- së, në këtë mënyrë duke e ri-kualifikuar pikën 1 nga akuza e Vrasjes së rëndë, në kundërshtim me Nenin 147, pika 4) dhe pikën 2 nga akuza e Tentim vrasjes së rëndë, në kundërshtim me nenin 147, pika 4).

## II.

Nën PIKËN 3, Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve:

i pandehuri **A.G.** shpallet **FAJTOR** për shkak se:

Më 4 dhjetor 2009, pas orës 12.00 pranë kryqëzimit të rrugëve "...." dhe "..." në Mitrovicë, më saktësisht jashtë shtëpisë së R. G., në rrugicën e vogël që kalon para shtëpisë së G. dhe që con në kthesën e majtë të shtëpisë së I., A.G. pa pasur leje të vlefshme të lëshuar nga organi kompetent, ishte në zotërim të një pistolette të mbushur të tipit M57-TT me numër serik ..., e cila më vonë u konfiskua nga policia.

PRANDAJ, **A.G. DËNOHET** për kryerjen e veprës penale të **Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi (2) të KPK-së.

## III.

Nën PIKËN 1, Vrasje e rëndë e I. I.

I pandehuri **S.G.** shpallet **FAJTOR** për shkak se:

Më 4 dhjetor 2009, pas orës 12.00 pranë kryqëzimit të rrugëve "..." dhe "..." në Mitrovicë, më saktësisht jashtë shtëpisë së R. G., në rrugicën e vogël që kalon para shtëpisë së G. dhe që çon në

kthesën e majtë të shtëpisë së I., S.G. me A.G., A. G. dhe R. G. u takuan me I. I., B. I. dhe M. I. Për shkak të një konflikti të vazhdueshëm ndërmjet familjeve të të ndjerit I. I. dhe R. G., anëtarët e të dy familjeve filluar të grinden me fjalë, e cila erdhi deri te një përlëshje me grushte në mes S.G. dhe B. I..

Pastaj B.I. hipi me shpejtësi në makinën e tij... bashkë me gruan e tij M.I. dhe shkuan në drejtim të qendrës së Mitrovicës në mënyrë që të kërkonin ndihmë nga policia, ndërsa anëtarët e tjerë të të dy familjeve qëndruan aty.

Pas një kohe të shkurtër, B.I. dhe M.I. u kthyen me .... Makina e policisë erdhi menjëherë pas ...- së dhe u ndal në anën perëndimore të rrugës së "...", ndërsa B.I. u kthye në rrugën "...".

Ndërsa B.I. po e ngiste veturën në rrugën "...", A.G., S.G., A. G., R. G. dhe I. I. po qëndronin në rrugën pranë kthesës së majtë të rrugicës.

Në të njëjtën kohë, një person tjetër dhe S.G., gjuajten me qëllim në drejtim të I. I. dhe e goditen I. I.; konkretisht S.G. shtiu me armë-pistoletë të tipit TT me numër serik ....

I. I., i cili kishte marrë plagë në anën e djathtë të kokës, anën e majtë të qafës, anën e djathtë të gjoksit, dhe në krahun e majtë, vdiq në në vend për shkak të shokut hemorragjik të shkaktuar nga lëndimet me armë zjarri.

Me këtë, S.G. ka privuar nga jeta viktimën I. I..

**PRANDAJ, S.G. DËNOHET** për kryerjen e veprës penale të **Vrasjes** në shkelje të nenit 146 të KPK-së në lidhje me nenin 23 të KPK-së, në këtë mënyrë duke e ri-kualifikuar nga akuza e Vrasjes së rëndë, në kundërshtim me nenin 147, pika 4) të KPK-së .

#### IV.

Nën PIKËN 2, Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve:

i pandehuri **S.G.** shpallet **FAJTOR** për shkak se:

Më 4 dhjetor 2009, pas orës 12.00 pranë kryqëzimit të rrugëve "... dhe ..." në Mitrovicë, më saktësisht jashtë shtëpisë së R. G., në rrugicën e vogël që kalon para shtëpisë së G. dhe që te çon në kthesën e majtë të shtëpisë së I., S.G. pa pasur leje të vlefshme të lëshuar nga organi

kompetent, ishte në zotërim të nje pistolette të mbushur të tipit TT me numër serik .., e cila më vonë u konfiskua nga policia.

PRANDAJ, **S.G. DËNOHET** për kryerjen e veprës penale të **Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi (2) të KPK-së.

## V.

PRANDAJ, në pajtim me dispozitat e nenit 36, paragrafi (1) nënparagrafi (2) dhe neni 38, paragrafët (1) dhe (2) të KPK- së, gjykata shqipton dënimet e mëposhtme:

- **A.G.** duke qenë i dënuar për veprën penale të Tentim vrasjes së rëndë nën pikën 1 dhe pikën 2 **DËNOHET** me katërbëdhjetë (14) vjet burgim;
- **A.G.** duke qenë i dënuar për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve, nën pikën 3 **DËNOHET** me një (1) vit burgim.

Në bazë të nenit 71, paragrafi (2) Nën-paragrafi (2) të KPK- së gjykata shqipton dënimin **E PËRGJITHSHËM** si në vijim:

**A.G. DËNOHET** me katërbëdhjetë (14) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim.

## VI.

PRANDAJ, në pajtim me dispozitat e nenit 36, paragrafi (1) nënparagrafi (2) dhe neni 38, paragrafët (1) dhe (2) të KPK -së, gjykata shqipton dënimet e mëposhtme:

- **S.G.** duke qenë i dënuar për veprën penale të Vrasjes nën pikën 1 **DËNOHET** me dhjetë (10) vjet burgim; dhe
- **S.G.** duke qenë i dënuar për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve, nën pikën 2 **DËNOHET** me një (1) vit burgim.

Në bazë të nenit 71, paragrafi (2) Nën-paragrafi (2) të KPK- së gjykata shqipton dënimin **E PËRGJITHSHËM** si në vijim:

**S.G. DËNOHET** me dhjetë (10) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim.

## VII.

Në pajtim me nenin 391, paragrafi (5) të KPPK-së, dhe në nenin 278, paragrafi (7) të KPPK- se, koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga **A.G.** nga 4 dhjetori 2009 deri në aktgjykimin përfundimtar, do t'i llogaritet ndaj dënimit.

## VIII.

Në pajtim me nenin 391, paragrafi (5) të KPPK-së, dhe në nenin 278, paragrafi (7) të KPPK, koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga **S.G.** nga 4 dhjetori 2009 deri në aktgjykimin përfundimtar, do t'i llogaritet ndaj dënimit.

## IX.

Arma - pistoleta e tipit TT në ngjyrë të zezë me numër serik ..., që përmban plumba **KONFISKOHET** në pajtim me nenin 60, paragrafi (1) dhe nenit 328, paragrafi (5) të KPK-së.  
Arma – pistoleta e tipit M57-TT me numër serik ....., që përmban plumba **KONFISKOHET** në pajtim me nenin 60, paragrafi (1) dhe nenit 328, paragrafi (5) të KPK-së.

## X.

Në mbështetje të nenit 102, paragrafët (1) dhe (4) të KPPK-së **A.G.** do të paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej katërqind (400) euro jo më vonë se 30 ditë nga dita që ky aktgjykim merr formën e prerë.

Në mbështetje të nenit 102, paragrafët (1) dhe (4) të KPPK-së **S.G.** do të paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej katërqind (400) euro jo më vonë se 30 ditë nga dita që ky aktgjykim merr formën e prerë.

## **XI.**

Në pajtim me nenin 112, paragrafi (2) i KPPK-së, palët e dëmtuara udhëzohen që të ndjekin të gjitha kërkesat e tyre pronësore juridike në kontest civil.

### **GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**

**P. Nr. 199/15**

**14 qershor 2016**

---

**Franciska FISER**

**Kryetare e trupit gjykues, Gjyqtare e EULEX-it**

---

**Vidar STENSLAND**

**Anëtar i trupit gjykues**

**Gjyqtar i EULEX-it**

---

**Rene Van VEEN**

**Anëtar i trupit gjykues**

**Gjyqtar i EULEX-it**

---

**Dukagjin KERVESHI**

**Procesmbajtës**



E përpiluar në gjuhën angleze, si gjuhë e autorizuar